

# Shërbimi Komunal Social

Kommunaler Sozialer Dienst

**Informacion | Këshillim | Ndhmë**  
për fëmijë, adoleshentë dhe familje

## Shërbimi Komunal Social

Shërbimi Komunal Social është një pikë takimi qendrore për fëmijë, adoleshentë, të rinj, prindër, nëna, baballarë dhe për kujdestarë të tjerë përgjegjës për edukimin si dhe për qytetare dhe qytetarë që kërkojnë këshilla.

Ne ofrojmë këshillim dhe mbështetje në çështjet personale, edukative dhe familjare.

Ne punojmë të orientuar në aspektin social dhe bashkëpunojmë në një rrjet me shërbime dhe institucione të tjera në Freiburg.

## Kontakt

Specialistin tuaj përgjegjës dhe oraret e tij të kontaktit për përcaktimin e takimeve dhe për sqarimin e shkurtër të problemit tuaj mund ta pyesni në recepsionin e zyrës tonë në numrin e telefonit +49 (0) 761 / 201-8601.

### Recepsioni ka orar pritje:

Nga e Hëna deri të Enjten nga ora 7.30 - 16.30

E Premte nga ora 7.30 - 15.30

Zyra e fëmijëve, adoleshentëve dhe familjes  
Kaiser-Joseph-Straße 143  
79098 Freiburg

kështu mund të na arrini me mjetet e transportit publik:  
VAG: Linjat 2, 4, 14 dhe 27  
Stacioni Siegesdenkmal





## Ne ofrojmë

- Mbështetje dhe nxitje për familjet,
- Këshillim dhe ndihmë në çështjet e edukimit të fëmijëve,
- Këshillim dhe ndihmë për situata të ndryshme jetësore familjare,
- Këshillim dhe ndihmë në situata jetësore personale të vështira,
- ndihmë personale për familje refugjatësh në banesa,
- kërkim i përbashkët i zgjidhjeve individuale dhe të orientuara në të ardhmen,
- Përcaktimi i ndihmave të përshtatshme dhe të nevojshme për edukimin,
- Mbështetje në zhvillimin e koncepteve të përbashkëta për marrjen përsipër të kujdesit prindëror në rast divorci, ndarje ose sjellje,

- Aktivizimi dhe forcimi i forcave vetjake të familjes dhe prindërve,
- Bashkëveprimi në procese gjyqësore familjare,
- mbrojtje aktive e fëmijëve,
- ndërmjetësimi dhe shoqërimi i fëmijëve tek familjet kujdestare,
- Këshillime në lidhje me temën e adoptimit dhe ndërmjetësimin të adoptimit,
- Përkujdesje për shtëpinë dhe familjen.

Ne jemi një skuadër specialistësh me përvojë dhe i trajtojmë me ndjeshmëri dhe besueshmëri informacionet që na besohen neve.

Bisedat këshilluese mund të zhvillohen tek ju në shtëpi ose në zyrat tona.

Këshillimi është falas.

## Puna sociale e qarkut

Për zonën e qytetit Freiburg ne jemi ndarë në katër fusha specifike.

Në një fushë specifike punojnë disa specialist të ndihmës sociale të cilët ofrojnë informacione, këshillime dhe mbështetje për fëmijët, adoleshentët, të rinjtë, prindërit, nënat, baballarët dhe për kujdestarë të tjerë përgjegjës për edukimin.

Funksioni qendror i punës sociale të rrethit janë furnizimi bazë social për familjet me fëmijë në zonën e qytetit Freiburg.

Ne ofrojmë prezencë normale dhe të ngutshme në zyrat tona dhe në lagje (orë bisede jashtë zyre, shërbime gatishmërie, vizita në shtëpi), sidomos në rast konfliktesh ose në situata krizash tek familjet me fëmijë.

Detyrat tona përcaktohen nëpërmjet detyrës ligjore.